

VENDIM
Nr. 14, datë 12.1.2018

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 198, DATË 4.5.1993, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3, të ligjit nr. 7582, datë 13.7.1992, “Për ndërmarrjet shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 198, datë 4.5.1993, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Paragrafi i parë i pikës 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Këshilli drejtues i EKB-së përbëhet nga 7 anëtarë:

- 1 (një) përfaqësues nga aparati i Kryeministrit;
- 2 (dy) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për strehimin;
- 1 (një) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet vendore;
- 1 (një) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën;
- 1 (një) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale;
- Drejtori i Përgjithshëm i Entit Kombëtar të Banesave.”.

b) Kudo në vendim, emërtimi “Ministria e Zhvillimit Urban” zëvendësohet me fjalët “... ministria përgjegjëse për strehimin ...”.

2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për strehimin dhe Enti Kombëtar i Banesave për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama